

Popullatat lokale të misrit të përshtatëshme për zona specifike të vendit

Prof.As. Dr. Kostandin Hajkola
QTTB Shkodër

Ne evolucionin e tyre bimët, kafshët qofte edhe njeriu, kane siguruar mbijetesën e tyre duke perfeksionuar sistemet e tyre “imunitare” ndaj faktorëve shkatërrues ne bashkëjetesën e pashmangshme. Bimët ne arealin e jetesës se tyre atakohen gjithmonë nga faktorët biotike dhe abiotike te dëmshëm për rritjen dhe zhvillimin normal te tyre. Ne procesin evolutiv ato kane krijuar sistemet e tyre te mbrojtjes. Po kështu edhe vete atakuesit perfeksionohen gjate evolucionit. Ne këtë beteje perfeksionimi gjithnjë mbijetojnë ato forma qe rezistojnë, pra, trashëgojnë veti e tipare te qëndrueshme ne ekosistemet.

Resurset gjenetike autoktone zotërojnë cilësi shume te vlefshme sidomos ne drejtim te përshtatjes. Popullatat autoktone te misrit ne Shqipëri paraqesin një variabilitet gjenetik te gjere dhe dinamik. Është kjo arsyeja qe burimet gjenetike autoktone ekotipe, popullata, raca ngelin ne qendër te kërkimeve si mjete apo vlera te pazëvendësueshme ne hartimin dhe aplikimin e programeve te përmirësimit gjenetik.

Jo vetem ne Shqipëri por ne te gjithë boten është shtruar me force ruajtja studimi dhe përdorimi i burimeve gjenetike. Ato marrin sot përparësi jo vetëm ne kuadrin e nje ekonomie tregu ku ato mund te shfrytëzohen ne mënyre direkt por edhe si një rezervuar i pashtershme germoplazme për sot dhe për brezat e ardhshëm për te përballuar sfida e vështirësi ne procesin e zhvillimit.

Përshkrimi morfologjik i popullatave lokale

Ne Shqipëri kane mbizotëruar popullata misri me cikël te shkurtër vegjetativ. Kjo ka qene e diktuar nga disa faktorë se pari mungesa e ujitjes dhe kullimit detyrojnë mbjellje te vona. Ne lartësitë mbi 600 metra ku gjendet edhe shpërndarja me e madhe e popullatave autoktone cikli i tyre i shkurtër përcaktohet nga faktorët klimatike dhe ekspozicioni ndaj dritës. Persa i takon zonave fushore be Shqipëri nuk ka patur ndonjë diversitet te madh te popullatave te misrit, me se shumti kane qene 8-10 popullata qe nga veriu deri ne jug ne pjesën e ulet fushore.

Një tipare tjetër i rëndësishëm i popullatave autoktone te misrit ne Shqipëri ka qene ngjyra e kokrrës e bardhe. Ky tipare ka qene i dëshirueshëm për faktin se misri është përdorur për buke dhe kjo ngjyre ka qene me e preferuara, por edhe e shoqëruar me strukture qelqore te kokrrës. Ne tërësinë e popullatave rreth 45% e tyre janë me kokërr te bardhe.

Përdorimi i misrit për buke ka diktuar edhe tiparin e kokrrës qelqore pasi ajo paraqet disa epërsi kundrejt kokrrës miellore. Epërsitë qëndrojnë kryesisht në rritjen e përmbajtjes së proteinave dhe cilësive bukenxënëse të miellit me prejardhje të kokërr qelqore. Mbi 70% e popullatave autoktone të misrit në Shqipëri janë të grupit me kokërr qelqore. Natyrisht që kjo nuk ka qenë rastësi pasi me këtë tipare lidhen edhe treguesit e tjerë si tolerance me e lartë apo rezistence ndaj faktorëve limitues të prodhimit si thatësira, sëmundjet e dëmtuesit. Pra ky grup popullatash ka qenë me rezistente se ato miellore pavarësisht se aftësia e tyre prodhuese ka qenë me e ulët se popullatat me kokërr miellore.

Rajoni i Shqipërisë veriperëndimore është ndër me të pasurit me popullata misri. Pjesa më e madhe e tyre i përket 2 racave, “Montenegrin” dhe “Teterreshteshi qelqor”

Disa nga popullatat kryesore në Shqipëri, arealet e origjinës dhe kultivimit

Nr	Popullata	Vend origjina	Lartësia mbi nivelin e detit	Areali i përhapjes	Ngjyra e kokrrës	Struktura e kokrrës
1	Reç i Bardhe	Reç, M. e Madhe	400-600	M. Madhe, Mali i Zi	Bardhe	Qelqore
2	Reçi verdhe	Reç, M. e Madhe	400-600	M. Madhe	Verdhe	Qelqore
3	Vermoshi	Vermosh	800-1000	Kelmend	Bardhe, Verdhe	Qelqore
4	Çelike	Dukagjin	300-400	Malësia Dukagjin	Bardhe	Qelqore
5	Oblike	Ana e Malit, Shkodër	200-300	Shkodër, Mali i Zi	Bardhe	Qelqore
6	Fare Krajë	Krajë, Mali i Zi	600-700	Shkodër, Mali i Zi	Verdhe	Qelqore
7	Gushtak	Dibër, Puke,	600-800	Dibër, Puke, Zona malore të ndryshme	Verdhe, I kuq	Qelqore
8	Dukat	Malësia e Vlorës	400-600	Malësia e Vlorës	Verdhe	½ Qelqore
9	Zhambaku	Sarandë	200-600	Sarandë, bregu detit	Verdhe	Qelqore
10	Filat	Korçë	700-900	Korçë, Kolonje, Përmet etj	Verdhe	Qelqore
11	Fare kuqi, Padesh	Tropojë	400-600	Malësia e Gjakovës, Tropojë	Verdhe	Qelqore
12	Mashkullore	Gjirokastrë	300-700	Gjirokastrë, Tepelene,	Verdhe	Qelqore
13	Sulove	Elbasan	200-600	Elbasan,	Bardhe	½ qelqore

14	Yzberish	Tirane	200-800	Tirane, Kavajë, Kruje	Bardhe	½ qelqore
15	Bullgari	Kruje	100-400	Kruje, Lezhe, Shkodër, Durrës	Bardhe	½ qelqore
16	Ungre	Mirdite	400-800	Mirdite	Bardhe	½ qelqore
17	Gostile	Kukës	400-600	Kukës	Bardhe	½ qelqore

%